

INFORMATË

Rreth organizimit të Ditës Fushore në parcelat demonstrues të grurit në Institutin Bujqësor të Kosovës (IBK), Pejë



Më datë 17 qershor 2025, në tokat e Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK) në Pejë, është mbajtur Dita Fushore për grurin, me qëllim të prezantimit të rezultateve të deritanishme nga projektit për ngritjen e parcelave demonstrative për testimin e kultivarëve të grurit në kushte të njëjta agroekologjike.

Në këtë aktivitet morën pjesë fermerë të angazhuar në prodhimtarinë e grurit, këshilltarë komunalë për bujqësi, **ekspertë të IBK-së, si dhe zyrtarë nga Departamenti për Shërbime Këshillimore dhe Teknike (DSHKT) në kuadër të MBPZHR**. Aktiviteti u organizua nga DSHKT në bashkëpunim me ekspertët e Institutit Bujqësor të Kosovës, në përputhje me Termat e Referencës të përgatitura nga DSHKT.



Qëllimi i projektit:

Projekti synon testimin dhe vlerësimin e performancës së pesë (5) kultivarëve të grurit (2 vendorë dhe 3 të importuar) duke aplikuar tre (3) metoda të ndryshme të praktikave agroteknike në secilën parcelë demonstrative në tokat e IBK-së.

Aktivitetet e realizuara deri më tani:

Faza I dhe Faza II e projektit janë realizuar me sukses, duke përfshirë aktivitetet në vijim:

- **Vendosja e pesë (5) parcelave demonstrative** në sipërfaqe nga 1 hektar, në tokat e IBK-së.
- **Analizat fiziko-kimike të tokës**, përfshirë përmbajtjen e makroelementeve dhe mikroelementeve, si dhe teksturën e tokës.
- **Përcaktimi i afateve mbjellëse** (A1 = 10.10.2024, A2 = 20.10.2024 dhe A3 = 30.10.2024).
- **Zgjedhja e kultivarëve** në bashkëpunim mes DSHKT dhe IBK.
- **Llogaritja e normave të farës dhe plehërimit bazik**, bazuar në analizat e tokës.
- **Përgatitja e tokës** (lavërim, pijatim, frezim), mbjellja dhe vendosja e metodave të ndryshme për secilën parcelë.
- **Monitorimi i rregullt i parcelave** nga eksperti i IBK-së, përmes formularëve standard të monitorimit dhe raportimit mujor.
- **Vlerësimi i parametrave agromorfologjikë dhe shëndetit të bimëve**, përfshirë lartësinë e bimëve, kallisjen dhe ndjeshmërinë ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.
- **Realizimi i dy plehërimeve plotësuese** (me URE 46% dhe NAG 27%) sipas normave të ndryshme për secilin kultivar, në përputhje me metodat e përcaktuara.
- **Aplikimi i preparateve për mbrojtjen e bimëve**, përfshirë herbicide, fungicide dhe insekticide, bazuar në nevojat e vërejtura në parcela.

Dita Fushore:

Ky aktivitet është organizuar në funksion të prezantimit të rezultateve paraprake nga fazat e para të projektit, si dhe për të ofruar këshilla teknike dhe shkëmbim përvojash ndërmjet fermerëve, këshilltarëve komunalë dhe ekspertëve të sektorit. Në ditën fushore u prezantuan:

- Diferencat mes kultivarëve të testuar deri në këtë fazë.
- Efektet e afateve mbjellëse dhe normave të plehërimit në zhvillimin vegetativ.
- Parashikimet për qëndrueshmëri ndaj sëmundjeve dhe ndikimin e praktikave të ndryshme agroteknike.

Pjesëmarrësit u njoftuan nga afër me metodologjinë e aplikuar dhe rëndësinë e vlerësimit të kultivarëve në kushte reale fushore për përcaktimin e rendimenteve dhe cilësisë.



Përfundim:

Projekti është në rrjedhë të mbarë dhe deri më tani janë realizuar me sukses të gjitha aktivitetet e parapara në Termat e Referencës për fazën I dhe II. Aktivitetet e fazës III – të korresjes dhe analizave laboratorike – do të realizohen sipas dinamikës së projektit, gjatë muajve korrik – gusht 2025. Rezultatet përfundimtare dhe përmbledhja analitike e projektit do të përfshihen në raportin final dhe në një broshurë profesionale për shpërndarje te fermerët dhe këshilltarët në nivel lokal. Po ashtu DSHKT brenda muajit Shtator do të organizoj edhe një konferencë me

fermer, këshilltar dhe palë tjera me interes ku do te prezantohen rezultatet ne detaje nga ky aktivitet.

